


## PERMBLEDHJE JO TEKNIKE

### PËR AKTIVITETIN

ID 1.7 GAZ NATÿROR AROMATIK OSE GNL PËRVEÇ RASTEVE KUR VEPRIMTARIA ËSHTË E LIDHUR ME TIPIN A, OSE PËRZIERJE E AROMAVE

ID.1.10 FURNIZIM ME KARBURANT I MAKINAVE NË NJË STACION TË FURNIZIMIT ME KARBURANT NË ZONAT URBANE.



SUBJEKTI: "GUESS" SH.P.K.


ADRESA: ELBASAN GRAMSH LAGJJA SPORTI, RRUGA ALI KOÇI, NDERTESE PRIVATE, ZONA KADASTRALE NR.1842 ME NR. PASURIE 10/343.

## Të dhëna mbi subjektin

Subjekti "GUESS" Sh.p.k me administrator Z. Agustin Braçe me numër identifikues NIPT M16809801M i regjistruar në QKR me datë 09.06.2021. Subjekti ushtron aktivitetin "Furnizime karburant i makinave në një stacion të furnizimit me karburant dhe GLN" që ndodhet në Elbasan Gramsh Lagjja Sporti, rruga Ali Koçi, ndertese private, zona kadastrale nr.1842 me nr. Pasurie 10/343. ". Kjo shoqëri është e specializuar në depozitimin dhe tregtimin me pakice me distributor të karburanteve (naftë,benzinë) dhe GLN ku punojnë punonjës me pervojë dhe ekperience në fushën e tregtimit të karburanteve.

Lloji i Karburantit: Benzinë,Naftë dhe GLN sipas standarteve të Bashkimit European.Në projektin e zbatimit, jepen të detajuara investimet e bëra për ngritjen e këtij impjanti.

- Një ndërtesë 1 kat për zyra dhe dhoma për punonjësit.
- Rezervuarët e naftës.
- Rezervuar i benzines.
- Rezervuari I GLN
- Distributorë 1 copë,një pomp me 6 pistoleta.
- Distributor GLN me nje pompe dhe 2 pistoleta
- Ambjenti i gjeneratorit.
- Ambjentet sanitare.
- Instalimet e furnizimit me energji eletrike të pajisjeve dhe të ndriçimit.
- Instalimet e mbrojtjes nga zjarri.



**PROJEKTI TEKNOLOGJIK: PIKË FURNIZIMI ME KARBURANTE DHE AUTOGAZ  
RRUGA ALI KOCI, LAGJA SPORTI, GRAMSH**

**1. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT**

Projekti "Pikë furnizimi me karburante dhe autogaz të automjeteve" parashikon ndërtimin e një stacioni të furnizimit me karburante benzinë, gazoil dhe GLN në rrugën Ali Koci, lagja Sporti Gramsh. Porositës i projektit është GUESS sh.pk., Agustin Braçe.

Për hartimin e projektit të përgjithshëm dhe atij teknologjik në veçanti për këtë objekt, janë marrë në konsideratë:

- Detyra e projektimit e dhënë nga investitori,
- Ligji 8450 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre,
- Ligi 8766 "Për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin,
- Ligji 8378 "Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë,
- VKM Nr. 1062 dt 23.12.2015. Për pajisjet dhe bashkësitë nën presion,
- Kushtet teknike dhe normat e projektimit për instalimet që shërbejnë për depozitimin, transportin dhe tregtimin e naftës dhe nënprodukteve të saj. Nr. 184, datë 5.07.2005.
- Standardet teknike për zgjedhjen e materialeve dhe aparaturave në përputhje me cilësitë fiziko mekanike të lëndës që do të tregtohet.

Projekti është i ndarë në këto pjesë:

1. Zona e depozitimit të karburanteve që përbëhet nga 1 rezervuar cilindrik horizontal prej çeliku me kapacitet të përgjithshëm 31400 litra, vendosur nën tokë. Rezervuari është me tre ndarje për depozitimin e tre produkteve me kapacitet respektiv 22400,6000 dhe 3000 litra,
2. Sistemi i tubacioneve dhe armaturave që lidhin rezervuarët me pompat,

3. Distributorët e karburanteve: 1 distributore për 3 produkte,
4. Ndërtesa e stacionit,
5. Rezervuar për gaz auto, nëntokësor, me kapacitet 5000 litra,
6. Distributor për gaz auto,
7. Mbrojtja e objektit.

#### A. SKEMA TEKNOLOGJIKE E KARBURANTEVE

Skema teknologjike është zgjedhur në funksion të llojeve të karburanteve që do të tregtohen, kapacitetit ditor të shitjeve dhe kushteve konkrete të terrenit. Janë parashikuar të depozitohen tre produkte me karakteristika kimiko-fizike si më poshtë.

1. Benzina është lëndë djegëse që përdoret si karburant në motorët të komanduar. Është një përzierje hidrokarburesh, të cilës nganjëherë i shtohen produkte të tjera djegëse ose ndihmëse. Në përbërje të saj mesatarisht gjenden:
  - 20% deri 30 % hidrokarbure të ngopur me formule  $C_nH_{2n+2}$ ,
  - 5% hidrokarbure të ngopur ciklike,
  - 30% deri 45% hidrokarbure jo të ngopur,
  - 30% deri 45% hidrokarbure aromatike, të familjes së benzenit.

Këto produkte janë në përgjithësi të dala nga distilimi i naftës. Nder hidrokarburet e ngopur dy luajnë rol të veçante: Oktani  $C_8H_{18}$  dhe Heptani  $C_7H_{16}$ . të cilet në fakt kanë veti krejtësisht të ndryshme për sa i përket tendences se tyre për vetëndezje.

Një përzierje ajri dhe oktani është e vështirë të ndizet vetvetiu, duhet kandela që të shkaktoje ndezjen. Në të kundert me heptanin vetëndezja është e lehtë për një shkallë shtypje relativisht të lartë ndezja në cilindër do të kryhet para se të jepet shkëndija në kandle. Ky fenomen karakteristik për motorët me benzine quhet rrahje dhe provokon valë goditëse në cilindër dhe zhurme karakteristike. Në rastin më të keq shkakton detonacion i cili mund të shkatërrojë pistonin.

### **Treguesi i oktanit**

Tendeca për vetëndezje të përzierjes së oktanit me heptanin janë të ndryshme. Ato shërbejnë si reference për të përcaktuar numrin e oktanit të një karburanti. Në qoftë se shkalla e komprimimit e nevojshme për tu shfaqur fenomeni rrahjeve në një përzierje ajër karburant në një motor reference është e njëjtë si për një përzierje me 95% oktan dhe 5% heptan, atëherë thuhet se karburanti ka numrin e oktanit 95. Kuptohet që numri oktanit mund të jetë nga 0 deri 100.

Gjatë shumë viteve, benzinës i shtohet një sasi tetrametil plumbi  $Pb(CH_3)_4$  ose tetraethyl plumbi  $Pb(C_2H_5)_4$  me qëllim uljen e tendencës për detonacion të benzinave me shumë heptan. Është një mënyrë për të rritur artificialisht numrin e oktanit (Fitohet 10 pikë me 1 g l-l te PTE) dhe për të favorizuar lubrifikimin e motorit, por kjo shkaktonë ndotjen e ambientit me një sasi të madhe plumbi të cilit i njihet toksiciteti. Benzinat me përmbajtje plumbi janë tashmë të ndaluara.

Llojet e ndryshme të benzinës aktualisht në treg janë:

- benzine pa plumb 95 ose Eurokarburant (numri oktanit 95),
- benzine pa plumb 98 (numri i oktanit 98 që e ben me pak ndotës),
- benzine "super" numri 98.

Ajo nuk përmban me plumb por fosfor për "anti-tkurjen e valvolave" dhe nga ky fakt shkakton probleme funksionimi.

Benzina pa plumb 98 është me detergjente se benzina 95 dhe paraqitet me korrozive ndaj pjesëve prej kauçuku. Këto dy karburante përmbajnë sasi të konsiderueshme përbërësish aromatike që janë shumë toksike. Duhet të evitohet thithja e avujve të tyre.

### **Të dhënat kimiko fizike:**

<b>Emërtimi:</b>	Benzine (hidrokarbur) N EINECS 289-220-8 (Numri i identifikimit të produktit sipas standardit evropian)
<b>Gjendja fizike:</b>	E lenget
<b>Vetitë kimike:</b>	Formula bruto parafine, cikloparafine, hidrokarbure olefinike dhe aromatike. $>C_3$
<b>Vetitë fizike</b>	

**T° shkrires:** <-60 °C  
**T° avullimit:** 20 deri 200 °C  
**Tretshmëria:** 100 deri 250 mg/l në ujë  
**Masa Volumetrike:** 680 deri 790 kg m ne (15 °C)  
**T° e vetëndezjes:** afersisht 250 °C  
**Pika e shkëndijës:** -40 °C  
**Kufiri i explodimit në ajër:** 1,3-7,1 % vol  
**Presioni i avujve të ngopur:** 350 deri 900 hPa (37,8 °C)  
**Rrezikshmëria:** Sinjalizimi i substancave të rrezikshme:



**Sinjalizimi i transportit:**



2. Gazoili ose nafta është emri karburantit që përdoret për motorët diesel. Është një karburant që del nga rafinimi i naftës bruto në temp midis 200 °C dhe 350 °C në presion atmosferik

Përbërja e tij është 75% hidrokarbure të ngopur (parafine dhe cikloparafine) dhe 25% hidrokarbure aromatike (naftaline dhe alkylbenzen). Formula e përafërt për gazoilin e zakonshëm është  $C_{12}H_{23}$  por shkon nga  $C_{10}H_{20}$  deri  $C_{15}H_{28}$ .

Gjate shumë viteve gazoili është kategorizuar nga përmbajtja e squfurit në të me përmbajtje të ulët dhe me përmbajtje shumë të ulët squfuri. Squfuri nuk lejon grumbullimin e depozitimeve në

tubin e daljes së gazeve. Megjithatë për shkak të presioneve të ambientalisteve përmbajtja e squfurit në gazoil në Evrope është ulur nga 500 mg/kg në 1996, në 10mg/kg në 2009.

#### Vetitë fiziko-kimike

No EINECS 270-676-1 (Identifikimi sipas Stand. European)

**Gjendja fizike:** lëng ngjyrë të verdhë

#### Vetitë fizike

**Temperratura e vlimit:** 170 deri 390 °C

**Tretshmëria:** Praktikisht e patretshme në ujë

**Masa volumetrike:** 820 deri në 860 kg/m<sup>3</sup> në 15 °C

**Temperatura e vetëndezjes:** 220 °C

**Pika e ndezjes:** > 55 °C ISO 2719

**Kufijtë e eksplodimit në ajër:**

- i poshtmi: 0,6 % vol
- I sipërmi: 6,5% vol


**Presioni i avujve te ngopur:** 1 mbar në 20 °C

**Viskoziteti dinamik:** 32,6 SUS-40,1 SUS (në 37,7 °C)

**Sinjalizimi i substancave toksike:**



**Sinjalizimi i transportit:**



Për depozitimin e gazoilit është parashikuar 1 rezervuar me kapacitet 22400 litra dhe 1 me kapacitet 6000 litra, ndërsa për benzinën 1 rezervuar me kapacitet 3000 litra. Rezervuarët janë prej çeliku me vendosje horizontale. Rezervuarët janë vendosur nën tokë secili me vete. Në tabanin e gropës vendoset një shtrese rëre, mbi të vendosen rezervuarët, nivelohen dhe me pas mbulohen me rërë deri në nivelin e bokaportës. Mbi të ndërtohet struktura e pusëtës së kontrollit, dhe mbi të vendoset trupi i pusëtës metalike në shtresën prej betoni dhe në fund shtrimi me pllaka betoni. Në bokaportat e rezervuarëve janë parashikuar të vendosen të gjitha lidhjet teknologjike: tubi i furnizimit, ai i thithjes së pompës, matjes së nivelit, tubacioni i ajrimit, etj. Materialet e zgjedhura janë të standardeve bashkëkohore dhe plotësojnë të gjitha normat e parrezikshmërisë dhe sigurisë në punë. Tubat që do përdoren janë parashikuar prej çeliku të zinkuar pa tegel.

Para se të vendosen në gropë, rezervuarët duhet të mbushen me ujë dhe të verifikohen për ndonjë rrjedhje ose deformim. Më pas lyhen me bojë antiruxhio një dorë dhe me bojë bituminoze dy duar. Sheshi ku do të vendosen distributorët është i mbuluar me tendë me konstrukcion metalik. Është parashikuar të vendoset 2 distributor për 3 produkte nga dy dalje. Pozicioni i distributorëve, distanca me aksin e rrugës është projektuar që të plotësojë kërkesat e Rregullores së Shfrytëzimit dhe të rregullores së Qarkullimit Rrugor. Janë parashikuar që të vendoset tabela e reklamës dhe tabela të tjera që tregojnë afrimin dhe hyrje daljet në objekt.

## **B. IMPIANTI I FURNIZIMIT ME GLN**

Gazi i lëngët, shkurtimisht GLN, është një përzierje hidrokarburesh ndër të cilët kryesoret janë propani dhe butani. Këto dy gaze kthehen në gjëndje të lëngët, pasi janë vënë nën presione jo shumë të larta dhe në temperaturë të ulët. Të kthyer në gjëndje të lëngët këto gaze janë lehtësisht të transportueshme, duke përdorur pajisje të posaçme nën presion (autocisternat).

Në kohët e sotme, në kuadër të zhvillimit të përgjithshëm të ekonomisë dhe në veçanti të transportit automobilistik, GAZI I LËNGËZUAR I NAFTËS (GLN) përfaqëson një komponent të rëndësishëm, në rritje të shpejtë të përdorimit dhe kjo për arsye se:



- Është i lehtë për tu transportuar. Kudo ku ka një rrugë mund të dërgohet.
- Plotëson çdo kërkesë. Ne fakt mund të përdoret nga ngrohja shtëpiake në atë industriale dhe si karburant.
- Ka një fuqi të lartë kalorifike. Duke djegur 1Kg GLN merret një sasi energjie e barabartë me 14 kË energji elektrike.
- Ekologjike. Nuk bën tym nuk lë mbetje, nga djegia e tij nuk çlirohen mbetje që ndotin ambientin.

#### Karakteristikat fizike dhe termodinamike të GLN

Karakteristikat

Propan Komercial

<b>Formula Kimike</b> Gjendja fizike ne kondita normale (760 mmHg, Presioni atm., 15°C,	C <sub>3</sub> H <sub>8</sub> i gaztë
<b>Masa Volumetrike:</b> Në gjëndje të lëngët në 15°C Në gjëndje të gaztë në 15 °C dhe 1013 mbar	0.51 kg/dm <sup>3</sup> 1.87 kg/dm <sup>3</sup>
<b>Densiteti në raport me ajrin:</b>	1.54
<b>Temperatura e vlimit në presion atmosferik:</b>	-42.1°C
<b>Presioni i Avullimit relativ:</b> Në +5 °C Në +15°C	0.52 Mpa (5.2 bar) 0.75 Mpa (7.5 bar)
<b>Nxehtësia latente e avullimit:</b> Në 15°C për Kg	356 KJ ose 98.8 Ëh (85Kal)
<b>Fuqia Kalorifike e sipërme:</b> Për Kg Për m <sup>3</sup> në 15°C dhe 1013 mbar	13.8 kËh (11.987 K.kal) 24.9 kËh 23.9 K.kal)
<b>Fuqia Kalorifike e poshtme:</b> Për Kg Për m <sup>3</sup> në 15°C dhe 1013 mbar	12.78 kËh (11.0 K.kal) 23.7 kËh (21.954 K.kal)
<b>Kufiri i ndezjes në ajër:</b> I poshtëm	2.4%

I sipërm	9.3%
Temperatura e vetëndejes në ajër:	515°C
Shpejtësia e përhapjes së flakës:	32 cm/sek
Temperatura maksimale e flakës në ajër	1920 °C
Nga 1 lt GLN merret afërsisht	270 lt gaz në presion atmosferik
Nga 1 kg GLN merret afërsisht	535 lt gaz në presion atmosferik

**"Impianti për furnizimin me gaz (GLN) të automjeteve"** parashikon furnizimin e automjeteve me gaz të lëngëzuar të naftës (GLN) pranë stacionit të furnizimit me karburante. Projekti paraqet në vetvete vendosjen e një rezervuari të GLN me kapacitet 5000 litra nëntokësor në një skid monoblok të paramontuar dhe lehtësisht të transportueshëm në një vend të paracaktuar në objekt. Rezervuari, nëpërmjet një elektropompe shumëshkallëshe për GLN, dërgon gazin në distributorin e vendosur në sheshin e stacionit. Në përbërje të impiantit janë sistemet e pajisjeve dhe aparatrave të cilat jepen në mënyrë të detajuar në pjesën grafike të Projektit. Materialet e zgjedhura janë të standardeve bashkëkohore dhe plotësojnë të gjitha normat e parrezikshmërisë dhe sigurisë në punë. Rezervuari dhe pajisjet e GLN duhet të jenë të certifikuar CE ndërsa pajisjet elektrike duhet të jene të shkallës EEx-d (explosionprof)

**Furnizimi i rezervuarit me GLN** do të bëhet nëpërmjet autobotëve nga pika e shkarkimit të tyre. Lidhja me autobotin do të bëhet me tubo fleksibël të pajisur me valvolat përkatëse, si dhe tokëzimi me pincë dhe përcjellës bakri për mbrojtjen nga shkarkimet hidrostatike

**Mbushja e automjeteve me GLN** do të bëhet me anë të distributorit ku do të lidhet pistoleta e mbushjes. Në linjën e mbushjes është vendosur një elektropompe centrifugale me kapacitet 50 lt/min me prevalencë 120m. Pompa është e pajisur me manometrën, valvolën e sigurisë si edhe një valvul diferenciale për shkarkimin e presionit të tepërt nga linjat. Tubacionet janë prej çeliku pa tegel, thithja DN32, ndërsa dërgimi DN32, për presion PN40. Pas montimit, rezervuari dhe sistemi i tubacioneve dhe armaturave i nënshtrohet provës hidraulike. Bëhet mbushja graduale me ujë dhe presohet deri në 23 kg/cm<sup>3</sup>. Prova quhet e suksesshme kur nuk vërehen rrjedhje dhe deformacione. Gjatë provës kontrollohen gjithashtu funksionimi i rregullt i pajisjeve dhe aparatrave (valvolat e sigurimit, manometrat, nivel treguesit etj.).

## **Ndikimet negative dhe pozitive të aktivitetit**

### **Efektet pozitive dhe negative të stacionit**

Funksionimi i stacionit për shitje të karburantit, (nafte ,benzine) vajrave lubrifikant të ambalazhuar dhe GLN ka në mënyre të natyrshme ndikimet e tij në mjedisin e zonës në fjalë, dmth në territorin që kufizon stacionin por edhe në ambjentet përreth.

Stacioni i administruar nga shoqëria, me stafin punonjës kryen:

- Aktivitetin kryesor, shitje të karburanteve dhe vajrave.
- Si dhe atë ndihmës (zyra).

Në mënyrë të vazhdueshme nga pikëpamja e këmbimit të efekteve e vlerave me mjedisin rrethues, ky aktivitet konsiderohet një proces i vijueshëm pune i stafit të stacionit për ruajtjen e përmisimin e vlerave mjedisore në territorin e stacionit të zonës përreth tij, për minimizimin e efekteve negative dhe shtimit të atyre pozitive.

### **Efektet pozitive**

Me realizimin e këtij projekti subjekti ndryshon këtë mjedis në favor të një stacioni të rregulluar, ku stacioni i shitjes së karburanteve bashkohore e moderne përbën një përmirësim të dukshëm nga ana vizuale.

Vendi i zgjedhur për shfrytëzimin e stacionit të shitjes së karburanteve dhe mjediseve të shërbimeve nga pikpamja e realizimit të këtij lloji aktiviteti, është mjaftë i favorshem. Stacioni së bashku me infrastrukturen e tij funksionale është i vendosur në krahun e djathtë të levizjeve të drejtuara të automjeteve duke favorizuar kështu hyrjet - daljet e tyre lirshëm e në përputhje me tendencen e trafikut duke shmangur kështu pengesat e konfuzionet që mund të lindin në të tilla raste në levizjen e njerëzve e automjeteve, e minimizuar aksidentet.

Një epërsi e dukshme në funksionimin e këtij stacioni në pozicionin në fjalë përbën faktin që ai gjendet në distancë të pranueshme largësie karshi zonave të banimit, duke mënjanuar kështu në një masë të konsiderueshme ndotjet dhe zhurmat për komunitetin.

Një stacion i tillë bashkohore zgjedh më së miri punësimin e 5 punonjësve, puntore shërbimi në distributore karburant etj, duke përfshirë këtu specialist hidrokarburesh, ekonomist, fakte që përbën një efekt pozitiv nga pikpamja sociale-ekonomike.

Në pjesën kufitare të stacionit dhe në veçanti në pjesën ballore të tij, janë krijuar sipërfaqe të mbjella me gjelbërim me bimë dekorative e lule natyrale. Efekti i tyre pozitiv natyrshëm kompeson efektet mjedisore të specifikës së aktivitetit, por edhe nga pamja vizuale, sipërfaqe të gjelberuara dhe mikroteritore shplodhëse në to, japin një tablo urbane të kënaqshme.

### **Efektet negative**

Në përgjithësi për shkak të specifikës së aktivitetit, stacioni që shfrytëzon tregtimin e karburanteve paraqet në funksionim e sipër mundësinë e lindjes dhe vepimit të efekteve negative me rezultat ndotjen mjedisore në territore, por edhe në ambientet përreth tij deri në një distancë të caktuar.

#### **Ndotjet të mjedisit mund të vijnë nga:**

- Rrjedhja e karburanteve apo lubrifikanteve gjatë furnizimit të automjeteve.
- Shpërndarja e gazrave në hapsirën që kufizon territorin, por dhe përreth tij.
- Qarkullimi i ujrave të ndotur në sipërfaqe si rezultat i funksionimit të aktiviteteve të shitjes së karburanteve, etj.

#### **Ndotje mund të jenë:**

- Ujrat dhe lëngjet që precipitojnë nga zonat e furnizimit me karburant
- Ujrat larës që kanë orgjinë larjen e territorit të stacionit e në veçanti pjesën e distributoreve, të zyrës së shërbimit, WC-së etj.

#### **Ndikimi nga zhurmat me origjinë të ndryshme mund të jete:**

- Nga trafiku
- Nga elektro-kompresori
- Nga elektro-gjeneratori

#### **Ndikimi në ndotjen e ajrit mund të jetë:**

- Nga avullimi i karburanteve
- Nga rritja e përqendrimit për shkak të pluhurave e tymrave të aktivitetit

#### **Ndikimi për raste aksidentale e rreziqe të tjera:**

- Zjarret mund të jenë prezent
- Avari të ndryshme gjithashtu mund të jenë prezente, etj.

#### **Ndikimi në rritjen e kërkesave për përballimin e problemeve të mësipërme nëpërmjet:**

- Shtrimin e sistemimit të territorit.
- Sigurimit teknik dhe instruktimi për MNZ i punonjësve e specialisteve që punojnë në Stacion, i cili është në nivelet e kërkuara sipas rregullores përkatëse në fuqi.
- Furnizimi me energji elektrike të jetë i vazhdueshëm.
- Automjete furnizuese (autobotet) janë të siguruara në fillim të shkarkimit e deri në fund.
- Furnizimi me ujë të pijshëm dhe me atë që përdoret gjatë punës.

- Problemi i zgjidhjes së kanalizimeve dhe seperatorit të ujrave të ndotura aksidentalisht.

### **Masat e marra për minimizimin e pasojave që mund të kenë në mjedis efektet e mësipërme negative dhe rritjen e atyre pozitive**

Bazuar në qellimet kryesore e në veçanti atë final, minimizimin në maksimum të efekteve negative të lart përmendura dhe rritjen e atyre pozitive në mjedis, stafi i Stacionit i administruar nga shoqëria “GUESS”Sh.p.k, kryen aktivitetin në Stacion duke marre e vene në zbatim masat konkrete si më poshtë:

Për ndotjen e mjedisit nga karburantet që mund të rrjedhin gjatë furnizimit të depozitave me autobot ose gjatë furnizimit të automjeteve në distributor

- Kanali i grumbullimit të ujrave dhe karburanteve që eventualisht mund të derdhen gjatë manipulimit të tyre, do të përfundojnë në Separatorin e ndarjes së hidrokarbureve nga uji;
- Çisterna e depozitimit të hidrokarbureve grumbullon mbetjet e ndotura gjatë aktivitetit, dhe mbas nje cikli kohor mblidhen keto të fundit per tu dorezuar për riciklim.
- Rezervuaret (kapacitetet depozituese) metalike janë me spesor mbi 4 mm, të tipit cilindrike horizontale, të lyer me bojë anti korodive dhe dy duar shtrese bituminoze. Bokaportet, linjat e furnizimit të dyfishtë si dhe tubat e ajrimin janë të montuar në rezervuare konforme kërkesave tekniko teknologjike të eneve nën presion. Ato vendosen në gropa me vaska betoni të hidroizoluara dhe material termoizolues e stabilizant. Mbas montimit të tyre dhe lidhjes së linjave të furnizimit me distributoret, ato provohen për ndonjë çarje të mundshme me zbatimin e një presioni hidraulik prej minimumi 0,75 kg/cm<sup>2</sup>;
- Furnizimi i rezervareve me karburante bëhet me autobote, parametrat teknike e teknologjike të cilëve janë në përputhje me kërkesat e eneve nën presion. Shkarkimi i karburanteve prej tyre bëhet nëpërmjet tubave të gomuar që sigurojnë një rrjedhje me presion konstant në tubacionet e pusetave përkatëse mbi bokaportet e rezervareve.
- Muftat bashkuese në të dy ekstremet e tubit të gomuar janë objekt i rëndësishëm kontrolli për riparim apo zëvendësim të mundshëm në rast dëmtimi.
- Furnizimi me karburant bëhet në distributore nëpërmjet pistoletave. Distributoret janë të vendosur në bazament betoni duke respektuar rigorozisht balancimin, distancat e lirshmëritë në manipulimet e ndryshme në to e perreth tyre. Gjatë shërbimit, kolaudimit apo ndonje riparimi të mundshëm të pjesëve të distributoreve (pompa, tuba fleksibel, pistolete, etj), merren masa që karburantet të derdhen në enë të posaçme apo

kanale lëngmbledhës që janë të ndërtuar pranë distributoreve dhe që vazhdojnë për t'i rikthyer në depozite, pa lejuar rrjedhje në mjedis.

### **Për ujrat e ndotura dhe me mbetje.**

- Ujrat e ndotura dhe me mbetje që precipitojnë në zonat e furnizimit, grumbullohen e trajtohen me separator të standartizuar, duke ndarë mbetjet hidrokarbure e derivatet e tyre vajore.
- Ujrat e godinave, zyrave dhe sheshit të pikës së karburantit që mund të precipitojnë nga rreshjet apo larjet në sheshin para tyre, kullojnë në kanalet anësore nga ku të grumbulluara, vazhdojnë të shkarkohen në pusetat anësore të Stacionit, e më tej në kanalën kryesor, që kalon aty pranë rrugës nacionale.
- Ujrat që precipitojnë nga mjedisi rrethues gjatë reshjeve, kullojnë e grumbullohen në kanalet anësore e pasandaj në kanalën kryesor të zones.
- Ujrat e zeza të WC-se, banjosh etj shkarkohen direkt në rrjetin e kanalizimeve në magjistralin kryesor të ujrave të zeza që perfundon në një gropë septike.

### **Për mbrojtjen e ujrave nëntokësore**

- Rezervuarët (kapacitetet depozitues) janë cilësisht të garantuara si dhe të provuara paraprakisht nën presion mbi atë të lejuarin. Po këtë garanci ka sistemi i tubacioneve furnizues të pompave të distributoreve dhe tubat e ajrimit. Siperfaqet e tyre në kontakt me tokën janë të përpunuara me bojë e lëndë hidroizoluese. Rezervuarët mbështeten në gropë në jastëke betoni dhe materiale inerte (rërë, granil, stabilizant) duke siguruar hermetizim të plotë nga bazamenti e paretet anësore argjilore e subargjilore të gropës. Gropa e rezervuareve duke qënë e betonuar, edhe në ndonjë rast të mundshëm çarje aksidentale e rrjedhje nuk lejon që të infiltrojnë menjëherë karburantet në ujrat nëntokësore. Në ndihmë të zbulimit të shpejtë të rasteve aksidentale të tillë, shërben vendosja në gropë e një sinjalizuesi automatik. Po kështu edhe linjat teknologjike janë të pajisura me aparaturë paralajmëruese në raste kontaminimi të mjedisit nëntoke.
- Në ndihmë të vazhdimit të aktivitetit për raste aksidenti është realizuar vendosja e një rezervuari rezerve.

Distributorët janë bashkëkohor dhe cilësisht të garantuar. Pjesët e tyre i nënshtrohen periodikisht kontrollit vizual e teknik, kryesisht për ndonjë çarje të mundshme për të cilat ka

sinjalizues automatik. Lidhjet teknologjike me rezervuaret garantohen nga sisteme tubash fleksibel të cilësisë së lartë. Tërësia e bazamentit të betonit dhe vendosjes së distributoreve në të janë konform parametrave rigorozisht të përcaktuar. Paralelisht me distributoret ndërtohet një kanal i vogël për të garantuar grumbullimin e rrjedhjeve në ndonjë rast të mundshëm, e që më tej drejton ato në një minidepozitë të posaçme për të tilla raste

### **Sistemi Kryesor i Furnizimit me Ujë.**

Uji grumbullohet në një depo të veçantë me një  $v=2000\text{m}^3$  e cila është e instaluar në një pjesë të aktivitetit.

### **Sistemi i Furnizimit me Energji Elektrike.**

Furnizime me energji elektrike i objektit bëhet nga ndërmarrja elektrike që administron rrjetin elektrik OSHEE Shpërndarje sipas kontratës lidhur me këtë ndërmarrje .

***GUESS SHPK***

**AGUSTIN BRAÇE**

